



© Këshilli i Evropës, 2021. Përkthimi jozyrtar i bërë nën Projektin "Forcimi i institucioneve të Kosovës\* në luftën kundër torturës, keqtrajtimit dhe trajtimit degradues". Projekti bashkëfinancohet nga ana e qeverisë Norvegjeze dhe Këshillit të Evropës. Ky përkthim nuk e obligon Gjykatën.

© Council of Europe, 2021. Unofficial translation made under the Project on "Strengthening Kosovo\* Institutions in Fight against Torture, Ill-treatment and Degrading Treatment". The project is funded by Norwegian government and the Council of Europe. This translation does not bind the Court.

© Conseil de l'Europe, 2021. Cette traduction non officielle a été faite dans le cadre de Project "Renforcer les institutions du Kosovo\* dans la lutte contre la torture, les mauvais traitements et les autres traitements dégradants". Le projet est financé par le gouvernement norvégien et le Conseil de l'Europe. Cette traduction ne lie pas la Cour.

\* Të gjitha referencat për Kosovën, si për territorin, institucionet apo popullsinë, në këtë tekst duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara dhe pa ndonjë paragjykim për statusin e Kosovës

\*All references to Kosovo, whether the territory, institutions or population, in this text shall be understood in full compliance with United Nations Security Council Resolution 1244 and without prejudice to the status of Kosovo.

\* Toute référence au Kosovo mentionnée dans ce texte, qu'elle concerne le territoire, les institutions ou la population, doit se comprendre en plein conformité avec la Résolution 1244 du Conseil de Sécurité de l'Organisation des Nations Unies et sans préjuger du statut du Kosovo.

Fletë faktesh – Dhuna ndaj Grave

Janar 2021

Kjo fletë faktesh nuk obligon gjykatën dhe nuk është e plotë

# Dhuna ndaj Grave

## Dhuna në familje

Shih fletën e fakteve në "[Dhuna në familje](#)".

## Keqtrajtimi në paraburgim

### Juhnke k. Turqisë

22 korrik 2003

Aplikantja u arrestua nën dyshimin e anëtarësimit në një organizatë të paligjshme të armatosur, PPK (Partia e Punëtorëve të Kurdistanit) dhe më vonë u dënua si e akuzuar dhe dënuar me 15 vjet burgim. Ajo u ankua në veçanti se, gjatë ndalimit të saj, ajo i ishte nënshtruar keqtrajtimit dhe një ekzaminimi gjinekologjik kundër vullnetit të saj.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, duke konstatuar se nuk kishte asnjë provë për të materializuar pretendimin e aplikantes se ajo i ishte nënshtruar keqtrajtimit, deklaroi atë pjesë të ankesës së saj **e papranueshme** si qartazi e pabazë. Gjykata më tej konstatoi pretendimin e aplikantes se ajo ishte detyruar të bënte një ekzaminim gjinekologjik dhe për këtë arsye vendosi se **nuk kishte shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) i [Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut](#). Sidoqoftë, Gjykata konstatoi që aplikantja i kishte rezistuar një ekzaminimi gjinekologjik derisa të bindej që të pajtohej me të dhe se, duke pasur parasysh cenueshmërinë e një të paraburgosuri në rrethana të tilla, nga aplikantja nuk mund të pritej që të rezistonte për një kohë të pacaktuar për një ekzaminim të tillë. Ajo vendosi të shqyrtojë atë çështje nga këndvështrimi i Nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës. Duke vënë në dukje se ekzaminimi gjinekologjik që i ishte imponuar aplikantes pa pëlqimin e saj të lirë dhe të informuar nuk ishte treguar të ketë qenë "në përputhje me ligjin" ose "i nevojshëm në një shoqëri demokratike", Gjykata vendosi se kishte **shkelje të Nenit 8** të Konventës. Kështu, në veçanti, ekzaminimi duket të ketë qenë një masë diskrete e marrë nga autoritetet për të mbrojtur ata anëtarë të forcave të sigurisë që kishin arrestuar dhe ndaluar aplikanten kundër një akuze të rreme për sulm seksual.

Sidoqoftë, ajo mbrojtje nuk justifikonte përpjekjen për të bindur një të paraburgosur që të pranonte një ndërhyrje të tillë imponues dhe serioze në integritetin e saj fizik, veçanërisht duke pasur parasysh që ajo nuk ishte ankuar se ishte sulmuar seksualisht.

## Dhuna policore

---

### **Aydın k. Turqisë**

25 shtator 1997

Shih më poshtë, nën "Përdhunimi dhe abuzimi seksual".

### **Y.F. k. Turqisë (kërkesa nr. 24209/94)**

22 korrik 2003

Në tetor 1993, aplikanti dhe gruaja e tij u morën në paraburgim policie nën dyshimin e ndihmës dhe mbështetjes së PPK-së (Partia e Punëtorëve të Kurdistanit), një organizatë e paligjshme. Gruaja e aplikantit u mbajt në arrest policie për katër ditë. Ajo pretendoi se e kishin mbajtur me sy lidhur dhe se zyrtarët e policisë e kishin goditur me shkopinj gome, e kishin fyer verbalisht dhe e kishin kërcënuar se do ta përdhunonin.



Ajo u ekzaminua nga një mjek dhe u dërgua te një gjinekolog për një ekzaminim të mëtejshëm. Zyrtarët e policisë qëndruan në ambiente ndërsa ajo u kontrollua pas një perde. Në mars 1994, aplikanti dhe gruaja e tij u shpallën të pafajshëm. Më 19 dhjetor 1995, tre zyrtarë policie u akuzuan për shkelje të jetës private të bashkëshortes së aplikantit duke e detyruar atë t'i nënshtrohej një ekzaminimi gjinekologjik. Ata u liruan nga akuzat në maj 1996. Aplikanti pretendoi se ekzaminimi i detyruar gjinekologjik i bashkëshortes së tij kishte shkelur Nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës.

Gjykata vendosi se kishte **shkelje të Nenit 8** (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës. Ajo konsideroi se, duke pasur parasysh cenueshmërinë e saj në duart e autoriteteve që kishin ushtruar kontroll të plotë mbi të gjatë ndalimit të saj, bashkëshortja e aplikantit nuk mund të pritej të bënte rezistencë ndaj ekzaminimit gjinekologjik. Rrjedhimisht kishte ndërhyrje në të drejtën e saj për të respektuar jetën e saj private. Qeveria turke nuk kishte arritur të demonstronte ekzistencën e një nevoje mjekësore ose rrethana të tjera të përcaktuara me ligj. Ndërsa Gjykata pranoi argumentin e tyre se ekzaminimi mjekësor i të paraburgosurve nga një mjek i mjekësisë ligjore mund të ishte një mbrojtje e rëndësishme kundër akuzave të rreme për ngacmim seksual ose keqtrajtim, ajo konsideroi se çdo ndërhyrje në integritetin fizik të një personi duhet të përcaktohet nga ligji dhe kërkonte pëlqimin e atij personi. Meqenëse nuk ishte marrë pëlqimi i personit në fjalë, ndërhyrja nuk kishte qenë në përputhje me ligjin.

#### **Maslova dhe Nalbandov k. Ruisë**

24 janar 2008

Shih më poshtë, nën "Përdhunimi dhe abuzimi seksual".

#### **Yazgül Yılmaz k. Turqisë**

1 shkurt 2011

Në këtë rast, aplikanti u ankua se, në moshën 16-vjeçare, ajo u ngacmua seksualisht ndërsa ishte në paraburgim policor. Asaj iu bë një ekzaminim gjinekologjik - i pashoqëruar dhe pa pëlqimin e saj ose të kujdestarit të saj - për të verifikuar nëse himeni i saj ishte shqyer. Pasi u shfajësua dhe u la e lirë, ajo vuante nga stresi post-traumatik dhe depresioni. Pretendimet e saj për sulmin në paraburgim u vërtetuan kryesisht nga ekzaminimet mjekësore të më pastajme. Asnjë procedim disiplinor nuk u mor kundër mjekëve të burgut në fjalë.

Gjykata vuri në dukje se ligji në atë kohë nuk ofronte masat e nevojshme mbrojtëse në lidhje me ekzaminimet e grave të paraburgosura dhe se kërkohehin garanci shtesë për ekzaminimet gjinekologjike, veçanërisht për të miturit. Praktika e përgjithshme e ekzaminimeve automatike gjinekologjike për të paraburgosurat femra - supozuar për të parandaluar akuzat e rreme të sulmeve seksuale kundër zyrtarëve të policisë - nuk ishte në interes të grave të ndaluara dhe nuk kishte asnjë justifikim mjekësor. Aplikanti ishte ankuar për ngacmim seksual, jo për përdhunim, i cili nuk mund të hidhej poshtë nga një ekzaminim i himenit të saj. Gjykata vuri në dukje se Kodi i ri turk i Procedurës Penale rregullonte ekzaminimet gjinekologjike, por nuk paraqiti ndonjë dispozitë specifike për të miturit. Ajo vendosi se kishte **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor) i Konventës në lidhje me ekzaminimet gjinekologjike të aplikantit ndërsa është në paraburgim policor dhe hetimin joadekuat në lidhje me përgjegjësit.

#### **B.S. k. Spaniës (nr. 47159/08)**

24 korrik 2012

Ky rast kishte të bënte me një grua me origjinë nigeriane e cila u ndalua nga policia ndërsa punonte si prostitutë në periferi të Palma de Majorkës. Aplikanti u ankua në veçanti që zyrtarët e policisë kombëtare e kishin abuzuar verbalisht dhe fizikisht gjatë ndalimit të saj për ta marrë në pyetje. Ajo më tej pretendoi se ishte diskriminuar për shkak të profesionit të saj si prostitutë, ngjyrës së lëkurës dhe gjinisë së saj.

Gjykata konstatoi se shteti spanjoll nuk kishte kryer një hetim adekuat dhe efektiv mbi pretendimet e aplikantit për keqtrajtim në dy raste kur ajo u ndalua dhe u mor në pyetje në rrugë, në **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) i Konventës sipas procedurave të saj.

Më tej, ajo konsideroi se gjykatat vendore nuk kishin marrë parasysh cenueshmërinë e veçantë të aplikantit, e natyrshme në situatën e saj si një grua afrikane që punonte si prostitutë dhe kështu kishin dështuar të përmbushnin detyrimin e tyre për të marrë të gjitha masat e mundshme për të konstatuar nëse një qëndrim diskriminues mund të kishte luajtur një rol në ngjarjet ose jo, në **shkelje të Nenit 14** (ndalimi i diskriminimit) **marrë bashkë me Nenin 3** të Konventës. Gjykata më në fund vendosi se **nuk kishte shkelje të Nenit 3** të Konventës në lidhje me pretendimet e aplikantit për keqtrajtim.

### İzci k. Turqisë

23 korrik 2013

Ky rast kishte të bënte me një grua turke e cila u ankua në veçanti se ishte sulmuar nga policia pas pjesëmarrjes së saj në një demonstratë paqësore për të festuar Ditën e Gruas në Stamboll dhe se një brutalitet i tillë policor në Turqi ishte toleruar dhe shpesh mbetej i padënuar.

Gjykata vendosi se kishte **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës si në aspektin e saj material dhe procedural, ashtu edhe **shkelje të Nenit 11** (liria e mbledhjes) të Konventës. Ajo konsideroi në veçanti se, si në shumë raste të mëparshme kundër Turqisë, zyrtarët e policisë kishin dështuar të tregonin një shkallë të caktuar të tolerancës dhe përmbajtjes përpara se të përpiqeshin të shpërndanin një turmë e cila nuk kishte qenë e dhunshme dhe as nuk paraqiste rrezik për rendin publik, dhe se përdorimi joproporcional i forcës kundër demonstruesve kishte rezultuar në lëndimin e aplikantit. Për më tepër, dështimi i autoriteteve turke për të gjetur dhe ndëshkuar zyrtarët e policisë përgjegjës ngriti dyshime serioze lidhur me pajtueshmërinë e shtetit me detyrimin e tij sipas Konventës për të kryer hetime efektive në lidhje me pretendimet e keqtrajtimit. Më në fund, përdorimi i dhunës së tepruar nga zyrtarët e policisë kishte pasur një efekt dekurajues në gatishmërinë e njerëzve për të demonstruar.

Në këtë rast, Gjykata përsëriti se një numër i madh i kërkesave kundër Turqisë në lidhje me të drejtën për lirinë e mbledhjes dhe/ose përdorimin e tepruar të forcës nga zyrtarët e zbatimit të ligjit gjatë demonstratave ishin në pritje. Duke marrë parasysh aspektin sistematik të problemit, ajo u kërkoi autoriteteve turke që të **miratojnë masa të përgjithshme, në përputhje me detyrimet** e tyre **sipas Nenit 46** (forca e detyrimit dhe ekzekutimi i aktgjykimeve) të Konventës, në mënyrë që të parandalohen shkelje të tjera të ngjashme në të ardhmen.

### Afet Süreyya Eren k. Turqia

20 tetor 2015

Arrestuar në qershor 1999 me dyshimin se është anëtare e një organizate politike të paligjshme, aplikanti pretendoi se ndërsa ishte në paraburgim ajo i ishte nënshtruar një keqtrajtimi që përbënte torturë. Për më tepër, ajo argumentoi se autoritetet kishin dështuar të kryenin një hetim efektiv mbi pretendimet e saj për keqtrajtim.

Gjykata vendosi se kishte **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës si në aspektin e saj material ashtu edhe në atë procedural. Duke pasur parasysh veçanërisht natyrën dhe shkallën e keqtrajtimit dhe konkluzionet e forta që mund të nxirren nga provat që kishin shkaktuar për të marrë informacion nga aplikanti në lidhje me dyshimin e saj të lidhur me një organizatë politike të paligjshme, Gjykata konstatoi se keqtrajtimi përfshinte vuajtje shumë serioze dhe mizore që mund të karakterizoheshin vetëm si tortura. Gjykata gjithashtu konstatoi se hetimi dhe procedimi penal pasues ishin joadekuat dhe si rrjedhojë në shkelje të detyrimeve procedurale të shtetit sipas Nenit 3.

### Dilek Aslan k. Turqisë

20 tetor 2015

Arrestuar në tetor 2006 ndërsa shpërndante fletëpalosje në mbështetje të familjeve të personave të privuar nga liria, aplikanti pretendoi se ajo i ishte nënshtruar keqtrajtimit nga policia dhe pohoi që autoritetet kishin dështuar të kryenin një hetim efektiv për këto pretendime.

Ajo gjithashtu argumentoi se ishte ndaluar me forcë nga shpërndarja e fletëpalosjeve të cilat kishin pasqyruar mendimet e saj.

Provat para Gjykatës nuk mundësuan konstatimin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se aplikanti i ishte nënshtruar keqtrajtimit nga policia. Prandaj ajo vendosi se **nuk kishte shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës në aspektin e saj material. Nga ana tjetër, Gjykata konstatoi se autoritetet kishin dështuar të kryenin një hetim adekuat dhe efektiv mbi pretendimet e aplikantit për keqtrajtim dhe për këtë arsye vendosi se kishte **shkelje të Nenit 3** të Konventës në aspektin e saj procedural. Së fundmi, Gjykata vendosi se **nuk kishte shkelje të Nenit 10** (liria e shprehjes) të Konventës.

### **Ebru Dincer k. Turqisë**

29 janar 2019

Ky rast kishte të bënte me një operacion të kryer nga forcat e sigurisë në Burgun Bayrampaşa (Stamboll) në dhjetor 2000, gjatë të cilit aplikanti pësoi djegie të rëndë në pjesë të ndryshme të trupit të saj, duke përfshirë fytyrën, për shkak të një zjarri që shpërtheu në pavijonin e grave.

Gjykata vendosi se kishte pasur **shkelje të nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës. Ajo konstatoi në veçanti se vetëm një hetim ose një procedurë efektive mund të mundësonte që të përcaktohet shkak i zjarrit. Sidoqoftë, gati 18 vjet pas fakteve, asnjë dritë nuk ishte hedhur mbi atë shkak dhe procedimet penale ishin ende në pritje në Gjykatën Assize. Për më tepër, procedimet vendore nuk kishin treguar që dhuna e cila kishte çuar në vuajtje fizike dhe mendore të aplikantit ishte e pashmangshme për shkak të sjelljes së saj.

### **Kërkesa në pritje**

#### **Lopez Martinez k. Spaniës (nr. 32897/16)**

Kërkesa i është komunikuar qeverisë spanjolle më 3 maj 2017

Ky rast ka të bëjë me hetimin e autoriteteve spanjolle mbi pretendimet e aplikantit për keqtrajtim nga policia.

Gjykata dha njoftimin për kërkesën tek qeveria spanjolle dhe u bëri pyetje palëve sipas Nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës.

## **Përdhunimi dhe abuzimi seksual**

### **X dhe Y k. Holandës (nr. 8978/80)**

26 mars 1985

Një vajzë me të meta mendore (aplikanti i dytë) u përdhunua, në shtëpinë për fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ku jetonte, të nesërmen e ditëlindjes së saj të gjashtëmbëdhjetë (e cila ishte moshë e pëlqimit për marrëdhënie seksuale në Holandë) nga një i afërm i personit që ishte përgjegjës aty. Ajo ishte e traumatizuar nga përvoja, por nuk ishte e gatshme të nënshkruajë një ankesë zyrtare duke pasur parasysh moshën e saj të ulët mendore. Babai i saj (aplikanti i parë) nënshkroi në vend të saj, por procedurat nuk u morën kundër autorit të veprës, sepse vajza duhej ta bënte ankesën vetë. Gjykata vendore pranuan se kishte zbrazëtitirë në ligj.

Gjykata rikujtoi se megjithëse objekti i Nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës është në thelb mbrojtja e individit nga ndërhyrjet arbitrare nga autoritetet publike, ajo nuk e detyron thjesht shtetin të abstenojë nga ndërhyrjet e tilla: përveç kësaj ndërmarrje kryesisht negative, mund të ketë detyrime pozitive të qenësishme në respektimin efektiv të jetës private ose familjare. Në rastin në fjalë, Gjykata konstatoi se mbrojtja e ofruar me ligj civil në rastin e keqbërjes së llojit të shkakuar aplikantit të dytë ishte e pamjaftueshme. Ky ishte një rast kur vlerat themelore dhe aspektet thelbësore të jetës private ishin në rrezik. Pengimi efektiv ishte i domosdoshëm në këtë fushë dhe mund të arrihej vetëm me dispozita të ligjit penal. Duke vënë në dukje se Kodi Penal holandez nuk e kishte siguruar atë me një mbrojtje praktike dhe efektive, Gjykata konkludoi, duke marrë parasysh natyrën e keqbërjes në fjalë, që aplikanti i dytë kishte qenë viktimë e **shkeljes së Nenit 8** të Konventës.

### Aydın k. Turqisë

25 shtator 1997

Aplikanti, një grua e re turke me origjinë kurde (e moshës 17-vjeçare në atë kohë) u arrestua pa shpjegime dhe u dërgua, së bashku me dy anëtarë të tjerë të familjes së saj, në paraburgim. Asaj iu lidhën sytë, u rrah, u zhvesh lakuriq, u vendos në një gomë dhe u lag me shtypje të fortë uji para se të përdhunohej nga një anëtar i forcave të sigurimit dhe më pas të rrihej përsëri për rreth një orë nga disa njerëz. Një ekzaminim mjekësor i mëvonshëm nga një mjek, i cili kurrë më parë nuk ishte marrë me raste përdhunimi, konstatoi himenin e saj të shqyer dhe të hapur si dhe mavijosje në kofshë. Aplikanti më tej pretendoi se familja ishte frikësuar dhe ngacmuar nga autoritetet për t'i detyruar ata që të tërhiqnin ankesën e tyre para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjykata theksoi se përdhunimi i një të paraburgosuri nga një zyrtar i shtetit duhet të konsiderohet të jetë një formë veçanërisht e rëndë dhe e urryer e keqtrajtimit duke pasur parasysh lehtësinë me të cilën kryesi i veprës mund të shfrytëzojë cënueshmërinë dhe rezistencën e dobësuar të viktimës së tij. Për më tepër, përdhunimi lë plagë të thella psikologjike tek viktima të cilat nuk i përgjigjen kalimit të kohës aq shpejt sa format e tjera të dhunës fizike dhe mendore. Kjo përvojë duhet ta ketë lënë aplikantin të ndihet e zhvlerësuar dhe e shkelur si fizikisht ashtu edhe emocionalisht. Gjykata konstatoi se akumulimi i akteve të dhunës fizike dhe mendore të shkaktuara aplikantit dhe akti veçanërisht mizor i përdhunimit të cilit ajo iu nënshtrua përbënin torturë, në **shkelje të Nenin 3** (ndalimi i torturës dhe trajtimi çnjerëzor ose degradues) të Konventës. Për më tepër, një pretendim për përdhunim nga një zyrtar në paraburgim kërkonte që viktima të ekzaminohej me gjithë ndjeshmërinë e duhur nga mjekë të pavarur me ekspertizën përkatëse. Kjo nuk ndodhi, duke e bërë hetimin të mangët dhe duke i mohuar aplikantit mundësinë e kompensimit, në **kundërshtim me Nenin 13** (e drejta për mjete juridike efektive) të Konventës.

### M.C. k. Bullgarisë (nr. 39272/98)

4 dhjetor 2003

Aplikantja, e moshës 14-vjeçare (që ishte mosha e pëlqimit për marrëdhënie seksuale në Bullgari), u përdhunua nga dy burra; ajo qau gjatë dhe pasi u përdhunua dhe më vonë u dërgua në spital nga nëna e saj, ku u zbulua se himeni i saj ishte shqyer. Për shkak se nuk mund të vërtetohej se ajo kishte rezistuar ose thirrur për ndihmë, autorët nuk u ndoqën penalisht.

Gjykata konstatoi **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit degradues) dhe **Nenit 8** (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës, duke vërejtur në veçanti trendin universal drejt njohjes së mungesës së pëlqimit si element thelbësor në përcaktimin e përdhunimit dhe abuzimit seksual. Viktimat e abuzimit seksual, veçanërisht vajzat e reja, shpesh nuk kanë arritur të rezistojnë për arsye psikologjike (ose duke u nënshtruar pasivisht ose duke u shkëputur nga përdhunimi) ose nga frika e një dhune të mëtejshme. Duke theksuar se shtetet kishin detyrim për të ndjekur penalisht çdo akt seksual jo-konsensual, edhe kur viktima nuk kishte rezistuar fizikisht, Gjykata konstatoi se hetimi në rast dhe ligji i Bullgarisë kishin mangësi.

### Maslova dhe Nalbandov k. Ruisë

24 janar 2008

Aplikanti, që ishte thirrur për t'u marrë në pyetje në stacionin e saj lokal të policisë, u detyrua nga zyrtarët e policisë të rrëfente përfshirjen në një vrasje. Një zyrtar policor i vuri pranga gishtit të madh, e rrahu, e përdhunoi dhe më pas e detyroi atë të bënte seks oral. Më pas ai dhe një zyrtar tjetër e goditën atë në mënyrë të përsëritur në stomak, i vendosën një maskë gazi në fytyrë, duke bllokuar ajrin për ta ngulfatur dhe aktivizuan energjinë elektrike përmes telave të lidhur në vathët e saj. Kur u lejua të shkonte në tualet, ajo u përpoq të presë venat në kyçet e saj. Tre zyrtarë të prokurorisë, pasi e morën në pyetje në stacionin e policisë, pinë alkool dhe vazhduan ta përdhunonin.

Aplikanti paraqiti një ankesë duke pretenduar se ajo ishte përdhunuar dhe torturuar. Një prezervativ i përdorur i gjetur në stacion u provua se kishte një probabilitet 99.99% të gjurmëve të qelizave të saj vagjinale. Pecetat njëpërdorimëshme u gjetën me gjurmë të spermës dhe sende të ndryshme të veshjeve me gjurmë të spermës dhe indeve vagjinale të të njëjtit grup antigjeni si aplikantit. Sidoqoftë, një gjykatë vendosi që provat e mbledhura ishin të papranueshme, pasi një procedurë e veçantë për fillimin e procedurave kundër zyrtarëve të prokurorisë nuk ishte ndjekur. Rasti u ndërpre përfundimisht për mungesë të provave të një krimi.

Gjykata vuri në dukje se kishte dëshmi impulsive dhe të paqartë në mbështetje të versionit të aplikantit për ngjarjet. Më tej, ajo përsëriti se përdhunimi i një të paraburgosuri nga një zyrtar i shtetit duhej të konsiderohej një formë veçanërisht e rëndë dhe e urryer e keqtrajtimit duke pasur parasysh lehtësinë me të cilën kryesi i veprës mund të shfrytëzonte cenueshmërinë dhe rezistencën e dobësuar të viktimës së tij. Dhuna fizike, veçanërisht aktet mizore të përdhunimit të përsëritur, të cilave aplikanti i ishte nënshtruar përbënte **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës. Më tej kishte **shkelje të Nenit 3** të Konventës sipas procedurës së saj, lidhur me hetimin joefektiv.

#### **P.M. k. Bullgarisë (nr. 49669/07)**

24 janar 2012

Ky rast kishte të bënte me ankesën e aplikantit që, përdhunuar në moshën trembëdhjetë vjeçare, autoriteteve bullgare u deshën më shumë se pesëmbëdhjetë vjet për të përfunduar hetimin pasues dhe ajo nuk kishte mjete juridike kundër ngurrimit të tyre për të ndjekur penalisht agresorët e saj.

Gjykata, duke konstatuar se hetimi mbi ankesën e aplikantit për përdhunim ishte joefektiv, edhe pse faktet e rastit dhe identiteti i shkelësve ishin vërtetuar, vendosi që kishte **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) i Konventës sipas procedurës së saj.

#### **I.G. k. Republikës së Moldavisë (nr. 53519/07)**

15 maj 2012

Aplikanti pretendoi që, në moshën katërmëdhjetë vjeçare, ajo ishte përdhunuar nga një i njohur (një burrë njëzet e tre vjeçare që jetonte në të njëjtën lagje me gjyshen e aplikantit, të cilën ajo e vizitonte shpesh). Ajo u ankua në veçanti se autoritetet nuk kishin hetuar pretendimet e saj në mënyrë efektive.

Gjykata vendosi që hetimi i rastit të aplikantit kishte dështuar në kërkesat e qenësishme për detyrimet pozitive të shtetit për të hetuar dhe ndëshkuar në mënyrë efektive të gjitha format e përdhunimit dhe abuzimit seksual, në **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës.

#### **M. dhe të tierët k. Italisë dhe Bullgarisë (nr. 40020/03)**

31 korrik 2012

Aplikantët, me origjinë rome dhe kombësi bullgare, u ankuan se, pasi kishin mbërritur në Itali për të gjetur punë, vajza e tyre u arrestua nga persona privatë me armë, u detyrua të punonte dhe të vidhte, dhe abuzohej seksualisht në duart e një familje rome në një fshat. Ata gjithashtu pretenduan se autoritetet italiane kishin dështuar të hetonin ngjarjet në mënyrë adekuate.

Gjykata i shpalli si qartazi të pabaza **ankesat sipas Nenit 4** (ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar) të aplikantit. Ajo konstatoi se nuk kishte asnjë provë që mbështeste ankesën e trafikimit të qenieve njerëzore. Sidoqoftë, ajo konstatoi se autoritetet italiane nuk kishin hetuar në mënyrë efektive ankesat e aplikantëve se vajza e tyre, e mitur në atë kohë, ishte rrahur dhe përdhunuar vazhdimisht në vilën ku ajo u mbajt. Gjykata prandaj vendosi se kishte **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës sipas procedurës së saj. Gjykata më në fund vendosi se **nuk kishte shkelje të Nenit 3** në lidhje me hapat e ndërmarrë nga autoritetet italiane për lirimin e aplikantit të parë.

### [P. dhe S. k. Polonisë \(nr. 57375/08\)](#)

30 tetor 2012

Aplikantët ishin një vajzë dhe nëna e saj. Në vitin 2008, në moshën katërmbëdhjetë vjeçare, aplikanti i parë mbeti shtatzënë pasi u përdhunua. Aplikantët u ankuan në veçanti për mungesën e një kornize gjithëpërfshirëse ligjore që garanton qasjen në kohë dhe të papenguar të aplikantit të parë në abort nën kushtet e përcaktuara nga ligjet në fuqi, dhe për zbulimin e informacionit në lidhje me rastin për publikun. Ata më tej u ankuan se heqja e aplikantit të parë nga kujdestaria e nënës së saj dhe vendosja në një strehimore për të mitur dhe më vonë në një spital kishte qenë e paligjshme dhe pretenduan se rrethanat e rastit përbënte trajtim çnjerëzor ose degradues.

Gjykata vendosi se ka pasur **shkelje të Nenit 8** (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, në lidhje me përcaktimin e qasjes në abort të ligjshëm, në lidhje me të dy aplikantët, dhe në lidhje me zbulimin e të dhënave personale të aplikantëve. Më tej u konstatua se kishte **shkelje të Nenit 5 § 1** (e drejta për liri dhe siguri) e Konventës, duke konstatuar në veçanti se qëllimi thelbësor i vendosjes së aplikantit të parë në strehimore për të mitur kishte qenë ndarja e saj nga prindërit e saj dhe parandalimi i abortit. Së fundmi, aplikanti i parë ishte trajtuar nga autoritetet në një mënyrë të mjerueshme dhe vuajtjet e saj kishin arritur pragun minimal të ashpërsisë sipas **Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor) të Konventës, në **shkelje** të asaj dispozite.

### [O'Keefe k. Irlandës](#)

28 janar 2014 (Dhoma e Madhe)

Ky rast kishte të bënte me çështjen e përgjegjësisë së shtetit për abuzimin seksual të një nxënëseje, nëntë vjeç, nga një mësimdhënës laik në një shkollë kombëtare irlandeze në vitin 1973. Aplikanti u ankua në veçanti se shteti irlandez nuk kishte arritur të strukturonte sistemin arsimor në mënyrë që ta mbronte atë nga abuzimi, si dhe ta hetonte ose të jepte një përgjigje të përshtatshme gjyqësore ndaj keqtrajtimit të saj. Ajo gjithashtu pohoi se nuk kishte qenë në gjendje të merrte njohjen dhe kompensimin për dështimin e shtetit për ta mbrojtur atë.

Gjykata vendosi se kishte **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) dhe të **Nenit 13** (e drejta për mjete juridike efektive) të Konventës në lidhje me dështimin e shtetit irlandez për të mbrojtur aplikantin nga abuzimi seksual dhe paaftësia e saj për të marrë njohjen në nivelin kombëtar të këtij dështimi. Më tej u konstatua se **nuk kishte shkelje të Nenit 3** të Konventës në lidhje me hetimin e ankesave të abuzimit seksual në shkollën e aplikantit.

### [W. k. Sllovenisë \(nr. 24125/06\)](#)

23 janar 2014

Ky rast kishte të bënte me procedime penale kundër një grupi burrash që kishin përdhunuar aplikantin në prill 1990, kur ajo ishte 18 vjeç. Aplikanti u ankua në veçanti se vonesat e gjata në procedimet penale kishin shkelur detyrimin e shtetit për të ndjekur penalisht në mënyrë efektive veprat penale të kryera kundër saj. Ndërsa asaj iu dha kompensim në nivel kombëtar për shqetësimin që pësoi si rezultat i procedurave të gjata, ajo konsideroi se shuma prej 5,000 eurosh që i është paguar asaj nuk mund të konsiderohej si dëmshpërblim i mjaftueshëm.

Gjykata vendosi që kishte **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës, duke konstatuar se procedurat penale në lidhje me përdhunimin e aplikantit nuk i respektuan kërkesat procedurale të vendosura në Nenin 3.

### [M.A. k. Sllovenisë \(nr. 3400/07\) dhe N.D. k. Sllovenisë \(nr. 16605/09\)](#)

15 janar 2015

Aplikanti u ankuan se Sllovenia kishte dështuar të siguronte një sistem efektiv të ndjekjes penale dhe gjykimit kundër burrave të cilët akuzoheshin për përdhunim, procedurat penale përkatëse duke zgjatur rreth 26 vjet në rastin e parë dhe mbi nëntë vjet në rastin e dytë.



Në të dy rastet, Gjykata vendosi që kishte **shkelje** procedurale (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës, duke konstatuar se procedurat penale në lidhje me përdhunimin e aplikantëve nuk i respektojnë kërkesat procedurale të vendosura në Nenin 3.

### **S.Z. k. Bullgarisë (nr. 29263/12)**

3 mars 2015

Aplikanti u ankua në veçanti për joefektivitetin e procedimeve penale për burgosjen false, sulmin, përdhunimin dhe trafikimin e qenieve njerëzore të kryera kundër saj. Ajo u ankua në veçanti për mungesën e një hetimi për përfshirjen e mundshme të dy zyrtarëve të policisë dhe dështimin për të ndjekur penalisht dy prej sulmuesve të saj, dhe për kohën e tepërt të marrë për të hetuar dhe gjykuar rastin. Ajo gjithashtu pohoi se zgjatja e tepruar e procedurave penale, për sa i përket kërkesës së saj për dëmet, kishte shkelur kërkesat e së drejtës për një seancë të drejtë dëgjimore brenda një kohe të arsyeshme. Së fundmi, ajo deklaroi se rasti i saj ishte ilustrim i një numri të caktuar të problemeve të përsëritura në lidhje me joefektivitetin e procedurave penale në Bullgari.

Gjykata vendosi se kishte **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës për shkak të mangësive në hetimin e kryer në burgosjen e paligjshme dhe përdhunimin e aplikantit, duke pasur parasysh veçanërisht vonesat e tepërta në procedurat penale dhe mungesën e hetimit të disa aspekte të veprave penale. Gjykata konstatoi se ishte shkak i një shqetësimi të veçantë që autoritetet nuk e kishin konsideruar të nevojshme për të shqyrtuar pretendimet e aplikantit për përfshirjen e mundshme në këtë rast të një rrjeti të organizuar kriminal të trafikimit të grave.

Gjykata gjithashtu vuri në dukje në këtë rast se tashmë, në mbi 45 aktgjykime kundër Bullgarisë, kishte konstatuar se autoritetet kishin dështuar të përmbushnin detyrimin e tyre për të kryer një hetim efektiv. Duke konstatuar se këto mangësi të përsëritura zbuluan ekzistencën e një problemi sistematik, ajo konsideroi, sipas **Nenit 46** (forca e detyrimit dhe ekzekutimi i aktgjykimeve) të Konventës, se i takonte Bullgarisë, në bashkëpunim me Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës, të vendoste se cilat masa të përgjithshme kërkoheshin në terma praktikë për të parandaluar shkelje të tjera të ngjashme të Konventës në të ardhmen.

### **I.P. k. Republikës së Moldavisë (nr. 33708/12)**

28 prill 2015

Aplikanti pretendoi se ajo ishte përdhunuar nga një burrë me të cilin ajo ishte lidhur për më shumë se një vit. Ajo pohoi në veçanti se autoritetet moldave nuk kishin arritur të hetonin pretendimet e saj për përdhunim në mënyrë të efektshme dhe se nuk kishte ligj penal efektiv ose mjete juridike civile në dispozicion për pretendimet e saj për përdhunim ose për pamjaftueshmërinë pasuese të hetimit.

Gjykata vendosi se kishte **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës sipas procedurës së saj, duke konstatuar se hetimi i rastit të aplikantit kishte dështuar në kërkesat e qenësishme për detyrimet pozitive të shtetit për të hetuar dhe ndëshkuar në mënyrë efektive të gjitha format e përdhunimit dhe abuzimit seksual. Ajo gjithashtu vendosi se kishte **shkelje të Nenit 13** (e drejta për mjete juridike efektive) të Konventës **marrë bashkë me Nenin 3** për sa i përket ankesës së aplikantit për mungesën e mjeteve juridike civile.

### **Y. k. Sllovenisë (nr. 41107/10)**

28 maj 2015

Ky rast kishte të bënte me ankesën e një gruaje të re në lidhje me procedimet penale të ngritura kundër një miku të familjes, të cilin ajo e akuzonte për sulm seksual të saj në mënyrë të përsëritur ndërsa ishte e mitur, duke pretenduar se procedimet ishin tepër të gjata dhe traumatike për të. Aplikanti pohoi në veçanti se hetimi mbi pretendimet e saj për sulm seksual ndaj saj dhe procedurat gjyqësore që pasuan ishin vonuar në mënyrë të paarsyeshme - që zgjati shtatë vjet midis depozitimit të ankesës së saj dhe shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë.

Ajo më tej u ankua për shkelje të integritetit të saj personal gjatë procedimit penal dhe në veçanti se ishte traumatizuar duke u marrë në pyetje nga vetë i pandehuri gjatë dy prej seancave dëgjimore në rastin e saj.

Gjykata vendosi se kishte **shkelje të detyrimeve procedurale të shtetit sipas Neni 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës, duke konstatuar në veçanti se, ndërsa ishte e pamundur të spekulohet nëse fakti që u deshën më shumë se shtatë vjet ndërmjet paraqitjes së ankesës së aplikantit dhe dhënies së aktgjykimit të shkallës së parë kishte paragjykuar rezultatin e procedurave, një vonesë e tillë nuk mund të përputhej me kërkesat për shpejtësi. Gjykata gjithashtu vendosi që kishte **shkelje të Nenit 8** (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, duke konstatuar se autoritetet slovene nuk kishin arritur të mbronin integritetin personal të aplikantit gjatë hetimit penal dhe gjykimit. Në veçanti, ata duhet të kishin parandaluar sulmuesin e pretenduar të përdorte gjuhë fyese dhe poshtëruese gjatë marrjes në pyetje të saj në seancë gjatë gjykimit. Autoritetet pa dyshim kishin marrë një numër masash për të parandaluar që aplikanti të traumatizohet më tej. Sidoqoftë, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e çështjes dhe moshën e saj të re në kohën kur sulmet e pretenduara seksuale kishin ndodhur, do të ishte kërkuar një qasje veçanërisht e ndjeshme. Për sa i përket natyrës së marrjes në pyetje nga vetë i pandehuri, Gjykata vuri në dukje se, ndërsa mbrojtjes i duhej lejuar një liri e caktuar për të sfiduar besueshmërinë e aplikantit, marrja në pyetje nuk duhet të përdoret si mjet frikësimi ose poshtërimi i dëshmitarëve.

#### **B.V. k. Belgjikës (nr. 61030/08)**

2 maj 2017

Aplikanti u ankua në veçanti se nuk ishte kryer një hetim i plotë dhe gjithëpërfshirës dhe se ajo nuk kishte mjet juridik efektiv me të cilin mund të ngrinte ankesa për përdhunim dhe sulm të pahijshëm nga një koleg i punës.

Gjykata vendosi se kishte **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës sipas procedurës së saj. Ajo konstatoi në veçanti se pretendimet e aplikantit ishin të diskutueshme dhe për këtë arsye mund të konsideroheshin si ankesa të trajtimit që shkelin Nenin 3 të Konventës. Prandaj, në funksion të detyrimit të shtetit për të kryer një hetim efektiv, autoritetet duhet, sapo ajo të kishte paraqitur ankesën e saj, të kishin përdorur shpejtë të gjitha mundësitë në dispozicion për të vërtetuar faktet dhe, sipas rastit, rrethanat që lidhen me aktet e pretenduara për përdhunim dhe sulm të pahijshëm. Prandaj, në rrethana të tilla, hetimi nuk mund të thuhet se ka qenë serioz dhe i plotë.

#### **E.B. k. Rumanisë (nr. 49089/10)**

19 mars 2019 (Aktgjykimi i Komitetit)

Aplikanti u ankua se autoritetet rumune nuk kishin arritur të hetonin siç duhet pretendimet e saj për përdhunim dhe kishin shkelur detyrën e tyre për të siguruar mbrojtje efektive ligjore kundër abuzimit seksual. Ajo deklaroi se autoritetet gjithashtu kishin dështuar ta mbronin atë si një viktimë e krimit pasi ajo nuk kishte pasur ndihmë juridike ose këshillim dhe ishte ekspozuar ndaj traumës që kishte shkelur integritetin e saj personal gjatë procedurave penale.

Gjykata vendosi që kishte **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) **dhe Nenit 8** (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës në rastin e aplikantit. Ajo zbuloi në veçanti se autoritetet rumune kishin dështuar të kryenin një hetim të duhur dhe kishin theksuar tepër faktin që aplikanti nuk i kishte rezistuar sulmuesit të saj të pretenduar. Për më tepër, për shkak të paaftësisë së lehtë intelektuale, rasti i saj kishte kërkuar një hetim të ndjeshëm të kontekstit, por nuk kishte asnjë të tillë. Gjykata gjithashtu konsideroi se qasja e autoriteteve kishte minuar të drejtat e aplikantit si viktimë e dhunës, kishte privuar ligjin vendor nga qëllimi i saj për të ndëshkuar efektivisht dhe ndjekur penalisht veprat seksuale dhe kishte ngritur dyshime në lidhje me sistemin e vendosur nga shteti rumun sipas detyrimeve të saj ndërkombëtare.

## **Mraović k. Kroacisë**

14 maj 2020<sup>1</sup>

Ky rast kishte të bënte me një ekuilibrim të së drejtës së aplikantit për një seancë dëgjimore publike në procedurat kundër tij për akuzat e përdhunimit dhe të drejtën e viktimës për mbrojtjen e jetës së saj private. Aplikanti u ankua se gjykatat vendore kishin justifikuar përjashtimin e publikut nga dëgjimi i rastit të tij thjesht nga nevoja për të mbrojtur jetën private të viktimës, pa e ekuilibruar këtë me të drejtën e tij për një seancë dëgjimore publike. As gjykatat vendore nuk kanë shpjeguar kurrë se pse ishte e nevojshme të përjashtohej publiku nga e gjithë procedura, në vend se vetëm nga seanca të caktuara dëgjimore.

Gjykata vendosi se **nuk kishte shkelje të Nenit 6 § 1** (e drejta për gjykim të drejtë) të Konventës në lidhje me aplikantin, duke konstatuar që arsyetimi i gjykatës vendore për përjashtimin e publikut nga procedurat, përkatësisht mbrojtjen e jetës private të viktimës, kishte qenë i arsyeshëm. Ajo theksoi në veçanti se shteti ishte i detyruar ta mbronte atë nga viktimizimi dytësor, duke pasur parasysh natyrën shumë të ndjeshme të marrjes në pyetje të saj në gjykatë, e cila zbulonte domosdoshmërisht informacion në lidhje me aspektet më intime të jetës së saj. Për më tepër, një informacion i tillë mund të ishte zbuluar në çdo fazë të gjyqimit penal të aplikantit, dhe për këtë arsye mbyllja e vetëm një pjese të procedurave nuk do të ishte e mjaftueshme për ta mbrojtur atë nga

### **Kërkesa në pritje**

#### **J.L. k. Italisë (nr. 5671/16)**

Kërkesa i është komunikuar qeverisë italiane më 29 janar 2018

Ky rast ka të bëjë me ankesën e aplikantit në lidhje me procedurat penale të ngritura kundër gjashtë burrave, të cilët ajo i akuzoi për sulm seksual ndaj saj.

Gjykata dha njoftimin për kërkesën tek qeveria italiane dhe u bëri pyetje palëve sipas Neneve 8 (e drejta respektimin e jetës private), dhe 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës.

sikletet e mëtejshme dhe stigmatizimi.

## **Rreziku nga keqtrajtimi në rast dëbimi**

### Gjymtimi i organeve seksuale femërore

#### **Collins dhe Akaziebie k. Suedisë**

8 mars 2007 (vendim mbi pranueshmërinë)

Aplikantët, shtetas nigerianë, janë nënë dhe bijë. Ato pretenduan se do t'i nënshtroheshin gjymtimit të organeve seksuale femërore nëse ktheheshin në Nigeri, në kundërshtim me Nenin 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës. Bordi Suedez i Migracionit refuzoi kërkesat e tyre për azil, statusin e refugjatit ose një leje qëndrimi, duke deklaruar, ndër të tjera, se gjymtimi i organeve seksuale femërore ishte i ndaluar me ligj në Nigeri dhe se ky ndalim ishte vënë në dukje në të paktën gjashtë shtetet nigeriane. Kështu, nëse aplikantët ktheheshin në një nga ato shtete nuk do të kishte gjasa që ato të detyroheshin t'i nënshtroheshin gjymtimit të organeve seksuale femërore. Aplikantët apeluan pa sukses, duke pohuar se praktika e gjymtimit të organeve seksuale femërore vazhdoi pavarësisht nga ligji kundër tij dhe kurrë nuk ishte ndjekur penalisht ose ndëshkuar.

Gjykata e shpalli kërkesën **të papranueshme** si qartazi të pabazë, duke konstatuar se aplikantët nuk kishin arritur të materializonin se do të përballeshin me një rrezik real dhe konkret për t'iu nënshtroar gjymtimit të organeve seksuale femërore pas kthimit në Nigeri. Nuk ishte në diskutim që nënshttrimi i një gruaje për gjymtim të organeve seksuale femërore përbënte keqtrajtimit në kundërshtim me Nenin 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës. As nuk ishte në diskutim që gratë në Nigeri tradicionalisht i ishin nënshtroar gjymtimit të organeve seksuale femërore dhe në një farë mase vazhdonte akoma.

<sup>1</sup>. Ky aktgjykim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në Nenin 44 § 2 (aktgjykimet përfundimtare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sidoqoftë, disa shtete në Nigeri kishin ndaluar gjyktimin e organeve seksuale femërore me ligj, duke përfshirë edhe shtetin nga kishin ardhur aplikantët. Për më tepër, ndërsa ishte shtatzënë, aplikanti i parë nuk kishte zgjedhur të shkonte në një shtet tjetër brenda Nigerisë ose në një vend fqinj, në të cilin ajo ende mund të kishte marrë ndihmë dhe mbështetje nga familja e saj. Në vend të kësaj ajo kishte arritur të siguronte mjetet e nevojshme praktike dhe financiare për të udhëtuar në Suedi, duke treguar kështu një sasi të konsiderueshme të forcës dhe pavarësisë. Shikuar në këtë aspekt, ishte e vështirë të shihej se pse ajo nuk mund ta mbronte vajzën e saj nga nënshtrimi i gjyktimit të organeve seksuale femërore, nëse jo në shtetin e saj të lindjes, të paktën në një nga shtetet e tjera në Nigeri ku gjyktimi i organeve seksuale femërore ishte i ndaluar me ligj dhe/ose më pak i përhapur.

### **Izevbekhai k. Irlandës**

17 maj 2011 (vendim mbi pranueshmërinë)

Aplikanti dhe dy vajzat e saj pohuan se vajzat rrezikojnë t'i nënshtrohen gjyktimit të organeve seksuale femërore nëse familja kthehej në Nigeri, në kundërshtim me Nenin 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës. Ato pretenduan se vajza e madhe e nënës vdiq në moshën një vjeçare nga gjakderdhja e madhe pasi gjyktimi i organeve seksuale femërore u krye nga një "plak/ë". Familja u largua nga Nigeria për në Irlandë përballë presionit nga familja e babait për të kryer gjyktimin e organeve seksuale femërore në dy vajzat më të reja. Kërkesa e tyre për azil ishte e pasuksesshme.

Gjykata e shpalli kërkesën **të papranueshme** si qartazi të pabazuar. Ajo konstatoi në veçanti se kishte arsye të forta për të dyshuar në pretendimet e bëra në lidhje me lindjen dhe vdekjen e vajzës së madhe. Familja ishte gjithashtu në një pozitë të privilegjuar financiare dhe shoqërore në Nigeri. Aplikanti i parë ishte një profesionist i arsimuar dhe bashkëshorti dhe prindërit e saj ishin kundër gjyktimit të organeve seksuale femërore. Asnjë përpjekje nuk u bë nga ajo ose bashkëshorti i saj për të raportuar ndonjë çështje në lidhje me vajzat e tyre dhe gjyktimin e organeve seksuale femërore në polici, për të kërkuar ndihmë ose për t'u zhvendosur në veri të Nigerisë, ku shkalla e gjyktimit të organeve seksuale femërore ishte dukshëm më e ulët ose e rrallë. Prandaj Gjykata konsideroi se ajo dhe bashkëshorti i saj mund të mbronin vajzat nga gjyktimi i organeve seksuale femërore nëse ktheheshin në Nigeri.

### **Omeredo k. Austrisë**

20 shtator 2011 (vendim mbi pranueshmërinë)

Aplikanti, i lindur në vitin 1973, u largua nga Nigeria në vitin 2003 për të shmangur gjyktimin e organeve seksuale femërore. Motra e saj tashmë kishte vdekur nga pasojat dhe ajo pretendoi se ekzistonte rreziku që fshatarët ta vrisnin nëse ajo refuzonte dhe se nëna e saj i kishte thënë asaj që ajo duhet të bashkëpunonte. Kërkesa e saj për azil ishte e pasuksesshme.

Gjykata e shpalli rastin **të papranueshëm** si qartazi të pabazuar. Nuk ishte në diskutim që nënshtrimi i çdo personi, fëmije ose të rrituri, për gjyktim të organeve seksuale femërore do të përbënte keqtrajtim në kundërshtim me Nenin 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës. Gjykata vuri në dukje, megjithatë, se ndërsa autoritetet vendore kishin konstatuar se frika e aplikantit për t'u detyruar t'i nënshtrohej gjyktimit të organeve seksuale femërore në Nigeri ishte e bazuar, ata konsideruan se ajo refuzoi një alternativë për fluturim të brendshëm brenda vendit. Prandaj, Gjykata duhej të vlerësonte situatën personale të aplikantit në Nigeri. Në këtë aspekt, ajo konstatoi se, duke pasur parasysh arsimin dhe përvojën e saj të punës si rrobaqepëse, kishte arsye për të besuar që aplikanti do të ishte në gjendje të ndërtonte jetën e saj në Nigeri pa u dashur të mbështetej në mbështetjen e familjes së saj.

### **Sow k. Belgjikës**

19 janar 2016

Aplikanti u ankua se ajo rrezikonte t'i nënshtrohej një procedure të mëtejshme heqjeje në rast të largimit të saj në Guineja, vendi i saj i origjinës, dhe se asnjë mjet juridik efektiv nuk kishte qenë në dispozicion të saj në lidhje me ankesën e saj.

Gjykata vendosi që **nuk kishte shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës në rast të largimit të aplikantit në vendin e saj të origjinës,

Fletë faktesh – Dhuna ndaj Grave

duke konstatuar se ajo nuk kishte arritur të materializonin një rrezik real për t'iu nënshtruar një procedurë të mëtejshme të heqjes në rast të largimit të saj në Guineja.

Gjykata gjithashtu vendosi se **nuk kishte shkelje të Nenit 13** (e drejta për mjete juridike efektive) të Konventës **bashkë me Nenin 3**.

### **Bangura k. Belgjikës**

14 qershor 2016 (vendimi për largim)

Aplikanti në këtë rast pretendoi se ajo rrezikonte gjymtimin e organeve seksuale femërore nëse kthehej në Sierra Leone, vendin e saj të origjinës.

Duke theksuar në veçanti se në janar 2016, aplikanti kishte marrë një leje qëndrimi në kontekstin e kërkesës së saj për bashkim familjar me bashkëshortin e saj dhe se për këtë arsye nuk kishte rrezik për kohën dhe për një periudhë të konsiderueshme kohore që ajo të dërgohej në Sierra Leone, Gjykata, në përputhje me Nenin 37 (heqja e kërkesave) të Konventës, konsideroi se nuk ishte më e justifikuar të vazhdohej shqyrtimi i kërkesës dhe **vendosi ta heqë lëndën nga lista**.

## Krimet dhe keqtrajtimet e nderit nga familja

### **A.A dhe të tjerët k. Suedisë (nr. 14499/09)**

28 qershor 2012

Ky rast kishte të bënte me shtetasit jemenas (një nënë dhe pesë fëmijët e saj) që jetojnë në Suedi në pritje të zbatimit të një urdhri dëbimi. Ata pretenduan se, nëse deportoheshin në Jemen, ata do të përballen me një rrezik real për të qenë viktimat të krimit të nderit pasi ata nuk i ishin bindur burrit/babait të tyre dhe ishin larguar nga vendi i tyre pa lejen e tij. Gjykatat suedeze konsideruan se problemet e familjes së aplikantit kishin të bënin kryesisht me sferën personale dhe kishin të bënin me çështje financiare, dhe jo me çështje nderi.

Gjykata konstatoi se arsyet materiale për të besuar se aplikantët do të ekspozoheshin ndaj një rreziku real për t'u vrarë ose për t'iu nënshtruar një trajtimi çnjerëzor ose degradues nëse do të dëboheshin në Jemen nuk ishin treguar në rastin në fjalë dhe për këtë arsye vendosi që **zbatimi i urdhrimit të dëbimit kundër aplikantëve nuk do të shkaktonte shkelje të Neneve 2** (e drejta për jetë) **ose 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) të Konventës.

### **R.D. k. Francës (nr. 34648/14)**

16 qershor 2016

Ky rast kishte të bënte me procedurën për dëbimin e aplikantit në Guineja, vendi i saj i origjinës. E martuar me një të krishterë, ajo kishte duruar të gjitha llojet e hakmarrjeve të dhunshme nga ana e babait dhe vëllezërve të saj myslimanë. Aplikanti pretendoi në veçanti se zbatimi i dëbimit të saj në Guineja do ta ekspozonte atë ndaj një rreziku trajtimi në kundërshtim me Nenin 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës.

Gjykata vendosi që **dëbimi** i aplikantit në Guine **do të përbënte shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës.

## Rreziku i trafikimit ose ritrafikimit

### **L.R. k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 49113/09)**

14 qershor 2011 (vendimi për largim)

Aplikanti pretendoi se ajo ishte trafikuar në Mbretërinë e Bashkuar nga Italia nga një burrë shqiptar që e detyroi atë të prostituonte në një klub nate duke mbledhur të gjitha paratë që i sillnin. Ajo u arratis dhe filloi të jetonte në një strehimore të paditur. Ajo pretendoi se largimi i saj nga Mbretëria e Bashkuar në Shqipëri do ta ekspozonte atë ndaj një rreziku për t'u trajtuar në shkelje të Neneve 2 (e drejta për jetë), 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues), 4 (ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar) dhe 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës.

Gjykata **vendosi ta heqë lëndën nga lista**, në përputhje me Nenin 37 (heqja e kërkesave) të Konventës, pasi konstatoi që aplikantit dhe vajzës së saj iu ishte dhënë statusi i refugjatit në Mbretërinë e Bashkuar dhe se nuk kishte më asnjë rrezik që ata të largoheshin në Shqipëri.

Qeveria gjithashtu kishte marrë përsipër t'i paguante aplikantit një shumë për shpenzimet ligjore të bëra prej saj.

#### **V.F. k. Francës (nr. 7196/10)**

29 nëntor 2011 (vendim mbi pranueshmërinë)

Ky rast kishte të bënte me procedurat për dëbimin e aplikantit në Nigeri, vendi i saj i origjinës. Aplikanti pretendoi në veçanti se nëse ajo dëbohej në Nigeri ajo do të rrezikonte të detyrohej të kthehej në unazën e prostitucionit nga e cila ajo ishte arratisur dhe t'u nënshtrohej hakmarrjeve nga ata që ishin të përfshirë dhe se autoritetet nigeriane nuk do të ishin në gjendje ta mbronin atë. Sipas këndvështrimit të saj, autoritetet franceze kishin për detyrë të mos i dëbonin viktimat e mundshme të trafikimit.

Gjykata e shpalli kërkesën **të papranueshme** si qartazi të pabazuar. Ndërsa ishte në dijeni të shkallës së trafikimit të grave nigeriane në Francë dhe vështirësive të përjetuara nga këto gra në raportimin tek autoritetet për të marrë mbrojtje, megjithatë ajo konsideroi, në veçanti, se informacioni i dhënë nga aplikanti në këtë rast nuk ishte i mjaftueshëm për të provuar se policia e dinte ose duhej ta dinte kur dha urdhrin për dëbimin e saj që aplikanti ishte viktimë e një rrjeti të trafikimit njerëzor. Sa i përket rrezikut që aplikanti të detyrohej të kthehej në një rrjet prostitucioni në Nigeri, Gjykata vuri në dukje se, ndërsa legjislacioni nigerian për parandalimin e prostitucionit dhe luftimin e rrjeteve të tilla nuk i kishte arritur plotësisht qëllimet e veta, megjithatë ishte bërë një përparim i konsiderueshëm dhe kishte të ngjarë që aplikanti të marrte ndihmë gjatë kthimit të saj.

Shih edhe: **Idemugia k. Francës**, vendimi mbi pranueshmërinë i 27 marsit 2012.

#### **F.A. k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 20658/11)**

10 shtator 2013 (vendim mbi pranueshmërinë)

Aplikanti, një shtetase e Ganës, pretendoi se ajo ishte trafikuar në Mbretërinë e Bashkuar dhe detyruar të prostituonte. Ajo u ankua në veçanti se largimi i saj në Gana do ta vinte atë në rrezik të binte në duart e ish-trafikantëve të saj ose në duart e trafikantëve të rinj. Ajo më tej pretendoi se, pasi kishte marrë HIV në Mbretërinë e Bashkuar si rezultat i drejtpërdrejtë të trafikimit dhe shfrytëzimit seksual, shteti ishte nën një detyrim pozitiv për ta lejuar atë të qëndronte në Mbretërinë e Bashkuar për të pasur trajtimin e nevojshëm mjekësor.

Gjykata deklaroi ankesat e aplikantit sipas Neneve 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) dhe 4 (ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar) **të papranueshme**. Ajo vuri në dukje në veçanti se aplikanti mund të kishte ngritur të gjitha ankesat e saj të Konventës në instancë më të lartë. Duke mos aplikuar për leje për t'u ankuar në instancë më të lartë, ajo kishte dështuar të përmbushte kërkesat e Nenit 35 § 1 (kriteret e pranueshmërisë) të Konventës.

#### **O.G.O. k. Mbretërisë së Bashkuar (nr. 13950/12)**

18 shkurt 2014 (vendimi për largim)

Aplikanti, një shtetase nigeriane, i cili pohonte se ishte viktimë e trafikimit njerëzor, u ankua se dëbimi i saj në Nigeri do ta ekspozonte atë ndaj një rreziku real të ri-trafikimit. Gjykata **vendosi ta heqë kërkesën nga lista e saj e lëndëve**, në përputhje me Nenin 37 (heqja e kërkesat) të Konventës, duke theksuar që aplikanti nuk rrezikonte më të dëbohej pasi i ishte dhënë statusi i refugjatit dhe një leje e pacaktuar për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar. Për më tepër, autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar kishin pranuar që ajo kishte qenë viktimë e trafikimit.

## Përfshirja sociale

#### **N. k. Suedisë (nr. 23505/09)**

20 korrik 2010

Aplikanti, një shtetase afgane që kishte një lidhje jashtëmartesore me një burrë në Suedi, pohoi se ajo rrezikonte përjashtimin shoqëror, burgim të gjatë apo edhe vdekje nëse kthehej në Afganistan. Kërkesat e saj për azil ishin të pasuksesshme.

Gjykata konstatoi se **dëbimi** i aplikantit nga Suedia në Afganistan **do të përbënte shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës. Ajo vuri në dukje se gratë ishin në rrezik të veçantë për keqtrajtim në Afganistan nëse perceptohet se nuk përputhet me rolet gjinore që u janë dhënë nga shoqëria, tradita dhe madje edhe sistemi ligjor. Fakti i vetëm që aplikanti kishte jetuar në Suedi mund të perceptohet sikur ajo e kishte kaluar kufirin e sjelljes së pranueshme. Fakti që ajo donte të divorcohej nga bashkëshorti i saj dhe nuk donte të jetonte më me të, mund të rezultonte në pasoja serioze që kërcënojnë jetën. Akti i Statusit Personal Shiit i Prillit 2009 kërkonte që gratë t'u bindeshin kërkesave seksuale të bashkëshortëve të tyre dhe të mos dilnin nga shtëpia pa leje. Raportet kishin treguar më tej se rreth 80% grave afgane ishin prekur nga dhuna në familje, veprime të cilat autoritetet i panë të ligjshme dhe për këtë arsye nuk i ndoqën penalisht. Gratë e pashoqëruara, ose gratë pa një "tutor" mashkull, u përballën me kufizime të vazhdueshme të mëdha për të pasur një jetë personale ose profesionale, dhe ishin të dënuara për përjashtim shoqëror. Ishte e qartë se atyre gjithashtu shpesh u mungonin mjetet për të mbijetuar nëse nuk mbroheshin nga një afërm mashkull. Në rrethanat e veçanta të këtij rasti, kishte arsye materiale për të besuar se nëse deportohej në Afganistan, aplikanti do të përballej me rreziqe të ndryshme kumulative të hakmarrjes nga bashkëshorti i saj, familja e tij, familja e saj dhe nga shoqëria afgane që binin në Nenin 3 të Konventës.

#### **W.H. k. Suedisë (nr. 49341/10)**

8 prill 2015 (Dhoma e Madhe)

Ky rast kishte të bënte me një dëbim të kërcënuar të një azilkërkuesi nga Suedia në Irak, ku ajo pretendoi se do të rrezikonte keqtrajtimin si një grua e vetme e konfesionit Mandaean, një pakicë e cënueshme etnike/fetare. Aplikanti pohoi se, një e divorcuar që i përket një pakice të vogël etnike/fetare të cënueshme, ajo do të rrezikonte realisht një trajtim çnjerëzor dhe degradues nëse kthehej në Irak. Ajo pretendoi në veçanti se, pa një rrjet mashkullor ose ndonjë të afërm të mbetur në Irak, ajo do të rrezikonte persekutimin, sulmin, përdhunimin, konvertimin e detyruar në një fe tjetër dhe martesën e detyruar.

Gjykata vuri në dukje se aplikantit i ishte dhënë një leje qëndrim pas një vendimi të Bordit të Migracionit të 15 tetorit 2014. Bordi konstatoi se situata e përgjithshme mbizotëruese e sigurisë në Bagdad, e kombinuar me faktin që aplikanti është një grua që i përket një pakice fetare dhe nuk ka asnjë rrjet social në Irak, do të thoshte se ajo kishte nevojë për mbrojtje në Suedi. Pas këtij vendimi, aplikanti deklaroi se ajo nuk dëshironte më të ndiqte kërkesën e saj para Gjykatës Evropiane. Prandaj, Gjykata konsideroi se çështja ishte zgjidhur në nivelin kombëtar. As nuk gjeti ndonjë rrethanë të veçantë në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut siç përcaktohet në Konventën Evropiane dhe Protokollin e saj të cilat i kërkonin Gjykatës të vazhdonte shqyrtimin e lëndës së saj. Ishte pra **e përshtatshme për heqjen e kërkesës nga lista e lëndëve të Gjykatës.**

#### **R.H. k. Suedisë (nr. 4601/14)**

10 shtator 2015

Aplikanti, një shtetase somaleze, pretendoi se, nëse largohej për në Mogadishu, ajo do të përballej me një rrezik real ose të vritej nga xhaxhallarët e saj për refuzimin të binte dakord për një martesë të detyruar para se të largohej nga Somalia ose të detyrohej të martohej përsëri me një burrë kundër vullnetit të saj pas kthimit të saj. Ajo më tej pohoi se situata e përgjithshme në Somali për gratë ishte shumë e vështirë, në veçanti për ato - të tilla si ajo - që nuk kishin një rrjet mashkullor dhe për këtë arsye ishin më të cënueshme.

Gjykata vendosi që **dëbimi** i aplikantit në Mogadishu **nuk do të përbënte shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës. Megjithëse nuk e anashkaloi gjendjen e vështirë të grave në Somali, përfshirë Mogadishun, Gjykata nuk mundi të konstatonte në faktet e veçanta të rastit të aplikantit se ajo do të përballej me një rrezik real të trajtimit në kundërshtim me Nenin 3 nëse kthehej në atë qytet. Kishte mospërputhje të konsiderueshme në parashtrësit e saj dhe pretendimet në lidhje me përvojat e saj personale dhe rreziqet me të cilat ajo përballej pas kthimit nuk kishin qenë të besueshme. Nuk kishte gjithashtu asnjë bazë për të konstatuar se ajo do të kthehej në Mogadishu si një grua e vetme me rreziqet që shoqëronte një situatë e tillë.

Në vend të kësaj, asaj iu desh të konsideronte qasjen si në mbështetjen e familjes ashtu edhe në një rrjet mbrojtës të meshkujve. As nuk i ishte treguar se duhet të kërkonte të jetonte në një kamp për refugjatët dhe personat e zhvendosur.

## Trafikimi i qenieve njerëzore<sup>2</sup>

### **Rantsev k. Qipros dhe Rusisë**

7 janar 2010

Aplikanti ishte babai i një gruaje të re e cila vdiq në Qipro, ku kishte shkuar për të punuar në mars 2001. Ai u ankua se policia qipriote nuk kishte bërë gjithçka që ishte e mundur për të mbrojtur vajzën e tij nga trafikimi ndërsa ajo ishte gjallë dhe për të ndëshkuar ata që ishin përgjegjës për vdekjen e saj. Ai gjithashtu u ankua për dështimin e autoriteteve ruse për të hetuar trafikimin e vajzës së tij dhe vdekjen pasuese dhe për të marrë hapa për ta mbrojtur atë nga rreziku i trafikimit.

Gjykata vuri në dukje se, ashtu si skllavëria, edhe trafikimi i qenieve njerëzore, për nga natyra e tij dhe qëllimi i shfrytëzimit, bazohet në ushtrimin e kompetencave që i bashkoheshin të drejtës së pronësisë; ai i trajtoi qeniet njerëzore si mallra që duhej të bliheshin dhe shiteshin dhe të viheshin në punë të detyruar; ai nënkuptonte mbikëqyrje të afërt të aktiviteteve të viktimave, lëvizjet e të cilave shpesh ishin të kufizuara; dhe ai përfshinte përdorimin e dhunës dhe kërcënimeve ndaj viktimave. Prandaj, Gjykata vendosi që vetë trafikimi ishte i ndaluar me Nenin 4 (ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar) të Konventës. Ajo arriti në përfundimin se kishte **shkelje** nga Qiproja **të detyrimeve pozitive që lindin sipas Nenit 4** të Konventës për dy çështje: së pari, dështimi i saj për të vendosur një kornizë të përshtatshme ligjore dhe administrative për të luftuar trafikimin si rezultat i regjimit ekzistues të vizave për artistë, dhe, së dyti, dështimi i policisë për të marrë masa operacionale për të mbrojtur vajzën e aplikantit nga trafikimi, përkundër rrethanave që kishin ngritur një dyshim të besueshëm se ajo mund të ketë qenë viktimë e trafikimit. Gjykata vendosi që kishte gjithashtu shkelje të Nenit 4 të Konventës nga Rusia për shkak të dështimit të saj për të hetuar se si dhe ku ishte rekrutuar vajza e aplikantit dhe, në veçanti, për të marrë hapa për të identifikuar ata që ishin të përfshirë në rekrutimin e saj ose metodat e rekrutimit të përdorura.

Gjykata më tej vendosi se kishte **shkelje** nga Qiproja **të Nenit 2** (e drejta për jetë) të Konventës, si rezultat i dështimit të autoriteteve qipriote për të hetuar në mënyrë efektive vdekjen e vajzës së aplikantit.

### **L.E. k. Greqisë (nr. 71545/12)**

21 janar 2016

Ky rast kishte të bënte me një ankesë nga një shtetase nigeriane e cila u detyrua të prostituonte në Greqi. Zyrtarisht e njohur si viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore për qëllime të shfrytëzimit seksual, aplikantit iu kërkua megjithatë të priste më shumë se nëntë muaj pasi i kishte informuar autoritetet për situatën e saj para se sistemi i drejtësisë t'i jepte atë status. Ajo pohoi në veçanti se dështimet e shtetit grek në përputhje me detyrimet e tij pozitive sipas Nenit 4 (ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar) të Konventës kishin sjellë shkelje të kësaj dispozite.

Gjykata vendosi se kishte **shkelje të Nenit 4** (ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar) të Konventës. Ajo konstatoi në veçanti se efektiviteti i hetimit paraprak dhe hetimit pasues të rastit ishin komprometuar nga një numër mangësish. Në lidhje me procedurat administrative dhe gjyqësore, Gjykata gjithashtu vuri në dukje vonesa të shumta dhe dështime në lidhje me detyrimet procedurale të shtetit grek. Në këtë rast Gjykata gjithashtu vendosi që kishte **shkelje të Nenit 6 § 1** (e drejta për një gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme) të Konventës, duke konstatuar se kohëzgjatja e procedimeve në fjalë kishte qenë e tepërt për një nivel të juridiksionit dhe nuk plotësonte kërkesën për "kohë të arsyeshme". Së fundmi, Gjykata vendosi që kishte **shkelje të Nenit 13** (e drejta për mjete juridike efektive) të Konventës, për shkak të mungesës në ligjin vendor të një mjete juridik përmes të cilit aplikanti mund të kishte zbatuar të drejtën e saj për një seancë dëgjimore brenda një kohe të arsyeshme.

<sup>2</sup>. Shih gjithashtu fletën e fakteve për "[Trafikimi i qenieve njerëzore](#)".



### **J. dhe të tierë k. Austrisë (nr. 58216/12)**

17 janar 2017

Ky rast kishte të bënte me hetimin e autoriteteve austriake në lidhje me një pretendim të trafikimit me qenie njerëzore. Aplikantët, dy shtetase filipinase, të cilat kishin shkuar për të punuar si shërbyese ose operët (au pairs) në Emiratet e Bashkuara Arabe, pretenduan se punëdhënësit e tyre u kishin marrë pasaportat e tyre dhe i kishin shfrytëzuar ato. Ato pretenduan se ky trajtim kishte vazhduar gjatë një qëndrimi të shkurtër në Vjenë, ku i kishin marrë punëdhënësit e tyre dhe ku ato ia kishin dalë të arratisen. Pas një ankese penale të paraqitur nga aplikantët kundër punëdhënësve të tyre në Austri, autoritetet konstatuan se ata nuk kishin juridiksion mbi veprat e pretenduara të kryera jashtë vendit dhe vendosën të ndërpresin hetimin në rastin e aplikantëve në lidhje me ngjarjet në Austri. Aplikantët pohuan se ato kishin qenë subjekt i punës së detyruar dhe trafikimit me qenie njerëzore dhe se autoritetet austriake nuk kishin arritur të kryenin një hetim efektiv dhe gjithëpërfshirës të pretendimeve të tyre. Ato argumentuan në veçanti se ajo që u kishte ndodhur atyre në Austri nuk mund të shihej e izoluar dhe se autoritetet austriake ishin të detyruara sipas ligjit ndërkombëtar të hetonin edhe ato ngjarje që kishin ndodhur jashtë vendit. **Gjykata, duke konstatuar se autoritetet austriake kishin respektuar detyrën e tyre për të mbrojtur aplikantët si viktimë (potenciale) të trafikimit me qenie njerëzore, vendosi se nuk kishte shkelje të Nenit 4** (ndalimi i punës së detyruar) dhe **as shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës. Veçanërisht ajo vuri në dukje se nuk kishte asnjë detyrim sipas Konventës për të hetuar rekrutimin e aplikantëve në Filipine ose shfrytëzimin e tyre të pretenduar në Emiratet e Bashkuara Arabe, pasi shteteve nuk u kërkohet sipas Nenit 4 të Konventës të parashikojnë juridiksionin universal mbi veprat e trafikimit të kryer jashtë vendit. Duke iu kthyer ngjarjeve në Austri, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet kishin ndërmarrë të gjitha hapat që mund të priteshin në mënyrë të arsyeshme për situatën. Aplikantët, të mbështetura nga një OJQ e financuar nga qeveria, ishin intervistuar nga zyrtarë policie të trajnuar posaçërisht, u ishin dhënë leje qëndrimi dhe pune në mënyrë që të rregullonin qëndrimin e tyre në Austri dhe ishte vendosur një ndalim për zbulimin e të dhënave personale për mbrojtjen e tyre. Për më tepër, hetimi mbi pretendimet e aplikantëve për qëndrimin e tyre në Vjenë kishte qenë i mjaftueshëm dhe vlerësimi që rezultonte nga autoritetet, duke pasur parasysh faktet e rastit dhe provat në dispozicion, kishte qenë i arsyeshëm. Çdo hap i mëtejshëm në këtë rast - siç është përballja e aplikantëve me punëdhënësit - nuk do të kishte ndonjë perspektivë të arsyeshme suksesi, pasi nuk ekzistonte asnjë marrëveshje e ndihmës juridike të ndërsjellë midis Austrisë dhe Emirateve të Bashkuara Arabe, dhe pasi aplikantët ishin drejtuar në polici afërsisht një vit pas ngjarjeve në fjalë, kur punëdhënësit e tyre ishin larguar prej kohësh nga vendi.

### **S.M. k. Kroacisë (nr. 60561/14)**

25 qershor 2020 (Dhoma e Madhe)

Ky rast kishte të bënte me ankesën e një gruaje kroate për trafik me qenie njerëzore dhe prostitucion të detyruar. Aplikanti u ankua për një përgjigje joadekuate procedurale zyrtare ndaj pretendimeve të saj.

Gjykata vendosi që kishte **shkelje të Nenit 4** (ndalimi i punës së detyruar) të Konventës për shkak të mangësive në hetimin e autoriteteve kroate për pretendimin e aplikantit për prostitucion të detyruar. Duke përfituar nga rasti, përmes rastit të aplikantit, për të sqaruar praktikën e saj gjyqësore mbi trafikimin me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për prostitucion, Gjykata theksoi në veçanti se ajo mbështetej në përkufizimin sipas ligjit ndërkombëtar për të vendosur nëse ajo mund të karakterizonte ose jo sjelljen apo një situatë si trafikimi me qenie njerëzore sipas Nenit 4 të Konventës dhe prandaj nëse ajo dispozitë mund të zbatohet në rrethana të veçanta të një rasti. Gjykata sqaroi gjithashtu se nocioni i "punës së detyruar ose të detyrueshme" sipas Nenit 4 të Konventës synonte të mbronte nga rastet e shfrytëzimit serioz, të tilla si prostitucioni i detyruar, pavarësisht nëse, në rrethanat e veçanta të një rasti, ato kishin të bënin me kontekstin specifik të trafikimit me qenie njerëzore. Ajo konstatoi se Neni 4 mund të zbatohet në rastin e aplikantit pasi karakteristika të caktuara të trafikimit dhe prostitucionit të detyruar patjetër që ishin të pranishme, të tilla si abuzimi i pushtetit mbi një individ të cenueshëm, detyrimi, mashtrimi dhe strehimi.

Në veçanti, abuzuesi i pretenduar i aplikantit ishte një polic, ndërsa ajo kishte qenë në kujdesin publik nga mosha 10-vjeçare, dhe ai së pari e kishte kontaktuar atë përmes Facebook-ut, duke e bindur atë të besonte se ai do ta ndihmonte për të gjetur një punë. Në vend të kësaj, ai kishte aranzhuar që ajo të ofronte shërbime seksuale, ose në banesën që ai e kishte marrë me qira ose duke e vozitur atë për të takuar klientë. Ajo situatë do të thoshte që autoritetet ndjekëse kishin qenë të detyruara për t'i hetuar pretendimet e aplikantit. Sidoqoftë, ata nuk kishin ndjekur të gjitha pistat e dukshme të hetimit, posaçërisht ata nuk kishin intervistuar të gjithë dëshmitarët e mundshëm, dhe për këtë arsye në procedurat gjyqësore kishte qenë çështja e fjalës së aplikantit kundër abuzuesit të saj të pretenduar. Mangësi të tilla kishin minuar rrënjësisht aftësinë e autoriteteve vendore për të përcaktuar natyrën e vërtetë të marrëdhënies midis aplikantit dhe abuzuesit të saj të pretenduar dhe nëse ajo ishte shfrytëzuar vërtet prej tij.

## Dhuna nga individë privatë

### **Sandra Janković k. Kroacisë**

5 mars 2009

Aplikanti u ankua në veçanti se, pavarësisht përpjekjeve të saj për të hetuar pretendimet e saj për sulm dhe kërcënim nga cimerat(et) e saj, autoritetet nuk kishin arritur të siguronin mbrojtjen e saj të duhur.

Gjykata vendosi se kishte **shkelje të Nenit 8** (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës, për shkak të dështimit nga autoritetet kroate për të mbrojtur në mënyrë adekuate aplikantin nga një sulm ndaj integritetit të saj fizik dhe të mënyrës në të cilën mekanizmat kombëtar të ligjit penal ishin zbatuar, në kundërshtim me detyrimet pozitive të shtetit sipas Nenit 8.

### **Ebcin k. Turqisë**

1 shkurt 2011

Aplikanti, me profesion mësuese, u sulmua në rrugë, gjatë rrugës për në punë, nga dy individë që i hodhën acid në fytyrë. Ajo nuk ishte në gjendje të punonte për një vit e gjysmë dhe iu nënshtrua terapisë për tri vjet. Ajo ende vuan nga pasoja serioze fizike. Ajo pretendoi në veçanti se autoritetet kishin dështuar në detyrimin e tyre për të mbrojtur sigurinë e saj dhe për të ndëshkuar menjëherë agresorët e saj.

Gjykata vendosi se kishte **shkelje të Neneve 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) dhe **8** (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës sipas procedurës së saj, duke konstatuar se procedurat administrative dhe penale nuk kishin arritur të siguronin mbrojtjen e duhur ndaj një akti serioz dhune.

### **Irina Smirnova k. Ukrainës**

13 tetor 2016

Ky rast kishte të bënte veçanërisht me abuzimin sistematik të kryer kundër aplikantit nga një grup kriminal dhe dështimin e pretenduar të autoriteteve ukrainase për ta parandaluar atë.

Gjykata vendosi se kishte pasur **shkelje të nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës. Ajo vuri në dukje në veçanti se natyra e përsëritur dhe e paramenduar e sulmeve verbale ndaj të cilave aplikanti iu nënshtrua së bashku me incidentet e dhunës fizike nga një grup burrash ndaj një gruaje të vetme të moshuar arriti pragun e ashpërsisë që kërkohej të hynte brenda fushës së Nenit 3 dhe përfshiu detyrën pozitive të shtetit për të vënë në lëvizje kornizën legislative dhe administrative mbrojtëse. Megjithëse shkelësit kryesorë u ndoqën penalisht dhe u dënuan me burgim të konsiderueshëm, autoriteteve ukrainase u deshën më shumë se dymbëdhjetë vjet për ta zgjidhur çështjen. Në funksion të vonësive ekstreme në inicimin dhe kryerjen e procedimeve penale, Gjykata konstatoi se Ukraina kishte dështuar të përmbushte detyrimin e saj pozitiv sipas Nenit 3 të Konventës.

### **Tërshana k. Shqipërisë**

4 gusht 2020<sup>3</sup>

Ky rast kishte të bënte me një sulm me acid mbi aplikantin në vitin 2009. Aplikanti dyshoi se ish-bashkëshorti i saj, të cilin ajo e akuzoi për dhunë në familje, fshihej pas sulmit. Ajo pretendoi në veçanti se autoritetet shqiptare nuk kishin arritur të merrnin masa për ta mbrojtur atë nga sulmi me acid dhe për të kryer një hetim të shpejtë dhe efektiv për identifikimin, ndjekjen penale dhe ndëshkimin e sulmuesit të saj.

Gjykata vendosi që **nuk kishte shkelje të Nenit 2** (e drejta për jetë) të Konventës në aspektin e tij materiale, duke konstatuar se shteti shqiptar nuk mund të mbahej përgjegjës për sulmin. Ajo vuri në dukje veçanërisht se, nëse shteti do të kishte qenë në dijeni të një rreziku për aplikantin, do të kishte qenë detyra e tij të merre masa parandaluese. Në rastin aktual, megjithatë, autoritetet kombëtare kishin konstatuar vetëm për sjelljen e dhunshme të ish-bashkëshortit të aplikantit pas incidentit. Nga ana tjetër, Gjykata vendosi që kishte **shkelje të Nenit 2** në aspektin e saj procedural, duke konstatuar se reagimi i autoriteteve ndaj sulmit me acid kishte qenë joefektiv. Në këtë drejtim, ajo vuri në dukje veçanërisht se hetimi mbi sulmin, i cili kishte karakteristikat e dhunës me bazë gjinore dhe për këtë arsye duhej të kishte nxitur autoritetet të reagonin me kujdes të veçantë, madje nuk kishin qenë në gjendje ta identifikonin as substancën e hedhur mbi të. Për më tepër, hetimi u ndal në vitin 2010, pa e identifikuar personin përgjegjës, dhe aplikantit nuk i ishte dhënë asnjë informacion në lidhje me progresin e hetimit, pavarësisht kërkesave të saj.

### **Sabalić k. Kroacisë**

14 janar 2021<sup>4</sup>

Aplikantja, e cila ishte sulmuar në një lokal nga një burrë të cilit ia kishte zbuluar orientimin e saj homoseksual, u ankua në veçanti për mungesën e një reagimi të duhur procedural të autoriteteve vendase për një akt dhune nga një palë private e motivuar nga orientimi i saj seksual.

Gjykata vendosi që **kishte shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) **bashkë me Nenin 14** (ndalimi i diskriminimit) të Konventës. Ajo konstatoi në veçanti se procedurat për kundërvajtje kundër agresorit të aplikantes nuk kishin adresuar elementin e krimit të urrejtjes së veprës dhe kishin rezultuar me një gjobë përcmuese. Këto mangësi kishin arritur në një defekt themelor në procedurë. Prandaj do të ishte justifikuar që autoritetet të ndërpresin ose anulojnë procedurat e kundërvajtjes dhe të rishqyrtojnë rastin, në vend që ata të refuzojnë ankesën penale të aplikantes për shkak të rrezikut të dyfishtë.

*Shih edhe:*

### **Pulfer k. Shqipërisë**

20 nëntor 2018

## Leximi më tej

Shih gjithashtu uebfaqen e Këshillit të Evropës për **"Dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje"**.

### **Kontakti i medias:**

Tel.: + 33 (0)3 90 21 42 08

<sup>3</sup>. Ky aktgjykim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në Nenin 44 § 2 të [Konventës](#).

<sup>4</sup>. Ky aktgjykim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në Nenin 44 § 2 të [Konventës](#).